

Agjenda për Kosovën: Sfidat e Qeverisë Haradinaj

Ky publikim është financuar nga:

Projekti për Promovimin e Shoqërisë Demokratike (DSP) - Financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Grupit për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) dhe nuk përfaqëson pozicionin e SCO-K, DANIDA ose KCSF.

dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë

Mohim i përgjegjesisë: Qëndrimet dhe analizat në këtë artikull janë tërësisht të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve

Autor: Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG)

Agjenda për Kosovën: Sfidat e Qeverisë Haradinajt

“Qeveria e Ramush Haradinajt trashëgoi një agjendë të ngjeshur dhe shumë sfiduese. Gjendja dhe konteksti politik nuk janë shumë të favorshme për qeverinë e re. Detyrat dhe obligimet e listuara më poshtë paraqesin prioritetet që kanë rëndësi për qytetarët, institucionet, partnerët ndërkombëtarë dhe për agjendën evropiane të Kosovës”.

Tre muaj pas zgjedhjeve të 11 qershorit, Kosova zgjodhi qeverinë e saj më 9 shtator. Koalicioni fitues PDK-AAK-NISMA arriti të formojë qeverinë vetëm me mbështetjen e Aleancës Kosova e Re (AKR) të Behgjet Pacollit, dhe të të gjithë 20 vendeve minoritare që përfaqësojnë serbët, boshnjakët, turqit dhe komunitetet RAE. Në shenjë proteste, Lëvizja Vetëvendosje me 32 dhe LDK-ja me 25 deputetë bojkotuan votimin e qeverisë. Gjashtëdhjetë e një nga 120 anëtarët e kuvendit e votuan kabinetin e Ramush Haradinajt. Me një shumicë të ngushtë kundër një opozite shumë të fortë, Qeveria e Haradinajt mund të jetojë gjatë, vetëm nëse tregon rezultate të mira.

Lista e çështjeve që kërkojnë zgjidhje është e madhe; ajo ngërthen detyrat dhe obligimet për përmbushjen e kërkesave për liberalizimin e vizave me BE-në, zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe impelmentimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ARE), reformën e Administratës Publike, avancimin e sistemit arsimor dhe shëndetësor, progresin në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rishikimin e sektorit të sundimit të ligjit si dhe përmirësimin e rritjes ekonomike dhe punësimit. Dialogu me Serbinë, gjithashtu, paraqet një tjetër sfidë të madhe për Qeverinë dhe Kuvendin.

Marrëdhëniet ndërmjet koalicionit qeverisës PAN dhe opozitës (Vetëvendosjes dhe LDK-së) mbeten të tensionuara. Fragmentarizimi i vazhdueshëm midis aktorëve kryesorë politikë, kërcënon performancën e qeverisë dhe mund të ndërpres mandatin e qeverisë së udhëhequr nga Haradinaj, në gjysëm. Ngjashëm, kërcënuese janë edhe marrëdhëniet e pakonsoliduara dhe agjendat e ndryshme brenda koalicionit qeverisës midis

PDK-së, AAK-së, NISMA-s dhe AKR-së. Kësaj radhe, qeveria varet nga 10 votat e përfaqësuesve serbë të cilët janë kryesisht në kontroll dhe mund të inicojnë rrëzimin e qeverisë, sa herë që lidershipi serb në Beograd dëshiron ta bëjë këtë.

Përkundër numrave të pakët në parlament (shumicës minore), Haradinaj mund të shtyejë përpara shumë çështje dhe reforma; mund të mobilizojë sektorët e qeverisë dhe rris llogaridhënien e ministrave dhe të zyrtarëve. Haradinaj dëshiron të adresojë me prioritet çështjet e qeverisjes së mirë, ofrimit të shërbimeve më të mira shëndetësore, zbatimit të MSA-së dhe reformave të tjera. Ai ka shprehur më pak interesim për dialogun me Serbinë dhe është i gatshëm që këtë çështje t'ia kalojë Presidentit Thaçi.

Sidoqoftë, Kryeministri ka nevojë të përmisojë marrëdhëniet me opozitën për një agjendë në rritje që kërkon një bazë të gjerë politike si, demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit, transformimi i Forcës të Sigurisë së Kosovës, politika e jashtme dhe reformat e tjera të rëndësishme. Nuk do të jetë i lehtë ndërtimi i marrëdhënieve konstruktive me opozitën; të gjithë akterët politikë, si në qeveri ashtu edhe në opozitë, kanë agjenda shumë kundërtë dhe historia e armiqësisë së tyre për shumë vjet, urrejtja dhe tensionet vështirë se do të tejkalohen shpejt.

Zgjedhjet e parakohshme të 11 qershorit [ishin të ndershme dhe demokratike](#); me disa mangësi të vogla. Subjektet ju pëmbajtën zotimit [të tyre për zgjedhje të lira, demokratike dhe njohje të rezultateve](#). Të shtrënguar nga [vendimi i Gjykatës Kushtetuese i korrikut 2014](#), subjektet politike u përfshinë në një partneritet të pashembullt parazgjodhor; LDK-ja e ish-Kryeministrit Mustafa ftoi AKR-në e Pacollit dhe Alternativën e Kryetares së Gjakovës, Mimoza Kusari për një koalicion të përbashkët. Lideri i PDK-së Kadri Veseli ftoi AAK-në e Ramush Haradinajt dhe NISMA-n e Fatmir Limajt, duke i dhënë fund rivaliteteve, që ekzistonin për një kohë të gjatë, midis ish-drejtuesve të luftës.. NISMA ishte ndarë nga PDK në vitin 2014. Si kurrë më parë, lideri i PDK-së Kadri Veseli nominoi Ramush Haradinajn e AAK-së për postin e Kryeministrit. Në këto zgjedhje, Lëvizja Vetëvendosje garoi e vetme.

Rezultatet befasuan skenën politike; shumë votues ndryshuan mendjen. Koalicioni PDK, AAK dhe NISMA (PAN) doli fitues, por humbi mbështetje të konsiderueshme; të gjithë së bashku, ata fituan 39 nga 120 ulëset në Kuvend. PDK-ja e Kadri Veselit humbi më së shumti. Vetëvendosja e Visar Ymeri dyfishoi votat duke u bërë partia e dytë me 32 ulëse në Kuvend. LDK-ja e ish

Kryeministrit Mustafa dhe partnerët e saj, AKR-ja e Behgjet Pacollit dhe e posa formuara Alternativa e Kryetares së Gjakovës Mimoza Kusari përfunduan të tretët me 29 ulëse. E përkrahur nga Beogradi, Lista Serbe fitoi 9 nga 10 vendet e garantuara për miniorotetin serb. 10 ulëset tjera u ndanë midis minoriteteve tjera, turqve dhe RAE.

Kombi në rritje i Kosovës tregoi se po kërkon ndryshime, duke ndihmuar Vetëvendosjen të dyfishojë mbështetjen, nga 16 sa kishin, në 32 në legjislacionin e ri në Kuvend. Vetëvendosja sfidoi dominimin e gjatë të PDK-së dhe LDK-së. Jo e gjithë vota e protestës do të mbetet në mbështetje të Vetëvendosjes, edhe pse trendet janë të dukshme. Zgjedhjet e ardhshme lokale të tetorit do të paraqesin një pasqyrë më të qartë dhe një projeksion më të lehtë.

Një muaj pas zgjedhjeve, më 8 korrik, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) certifikoi rezultatet e zgjedhjeve; vonesat e gjata në publikimin e rezultateve reflektojnë të metat e sistemit zgjedhor. Megjithatë, kjo vonesë nuk ishte përmabajtësore; subjektet politike për shkak të mungesës së numrave nuk ishin gati për të formuar institucionet. Kosova po shkonte drejt një krize të re politike për faktin se liderët nuk ishin të gatshëm për kompromis dhe bashkëpunim.

[Vendimi i Gjykatës Kushtetuese \(2014\)](#) i jep të drejtën subjektit ose koalicionit që në zgjedhje ka fituar numrin më të madh të votave për të zgjedhur kryetarin e kuvendit dhe të drejtën për të nominuar kryeministrin. PAN-i e fitoi këtë të drejtë por, megjithatë, nuk i kishte numrat e mjaftueshëm. Thirrjet e Veselit dhe Haradinajt që LDK t'i bashkohet një qeverie me bazë të gjerë shkuan huq. LDK refuzoi çdo formë bashkëpunimi me koalicionin e udhëhequr nga PDK; ende është i freskët zemërimi me PDK-në për mbështetjen që i dha opozitës për [votëbesimin kundër qeverisë së udhëhequr nga Isa Mustafa i LDK-së](#). Mustafa gjithashtu refuzoi bashkëpunimin me Albin Kurtin; Përgjatë viteve 2015 dhe 2017, Vetëvendosja i kishte [shkaktuar vuajtje të papara qeverisë së Isa Mustafës](#). Me një rritje të shpejtë të mbështetjes publike, udhëheqja e Vetëvendosjes nuk ndjenë nevojën për të bërë kompromise me askënd.

Në këto rrethana, mundësia e vetme për të formuar qeverinë ishte që të fitohej përkrahja e AKR-së së Behgjet Pacollit. Negociatat zgjatën disa javë. AKR përdori mundësinë e 'të qenit përcaktues' për të negociuar një marrëveshje të leverdishme; me vetëm tre deputetë (një të dorëhequr) AKR

fitoi postin e zëvendëskryeministrit të parë dhe katër ministri, ministrinë e punëve të jashtme, ministrinë e punëve të brendshme, ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe ministrinë e zhvillimit ekonomik.

Qeveria e Ramush Haradinajt përfshin një marrëveshje të katër subjekteve shqiptare, si dhe grupeve parlamentare serbe dhe të pakicave. Kjo mund të komplikojë çështjet në planin qeverisës, dhe mardhëniet brenda saj. Ndarja e posteve, politikat e pakonsoliduara dhe shumë pikëpamje dhe agjenda kundërtëne do ta bëjnë të vështirë ndërtimin e kohezionit, për të cilin Haradinaj ka shumë nevojë.

Qeveria dhe opozita kundërshtojnë legjitimitetin e njëri-tjetrit dhe politikat që përfaqësojnë. Për partitë në pushtet, opozita synon të bllokojë punën e qeverisë. Opozita kritikon qeverinë se është e varur jashtëzakonisht nga Beogradi; Qeveria e Haradinajt varet nga dhjetë vota të pakicës serbe. Marrëdhëniet politike janë të komplikuar edhe më shumë me futjen në ciklin e ri të zgjedhjeve lokale, kësaj radhe shumë më të tensionuara.

Dy javë pas formimit të qeverisë, agjenda e saj u ngatërrua me zgjedhjet e radhës. Fushata për zgjedhjet lokale filloi më 21 shtator dhe zgjedhjet do të mbahen më 22 tetor. Rezultatet e papritura dhe të pakëndshme të qershorit kane rritur ambicjet për zgjedhjet e radhës. Kësaj radhe, lufta e subjekteve politike do të jetë shumë më e ashpër: për PDK-në dhe LDK-në të vërtetojnë se trendet e zgjedhjeve të qershorit ishin të gabuara; për Vetëvendosjen të përsërisë suksesin e zgjedhjeve të përgjithshme dhe të konsolidojë mbështetjen.

Qeveria premtonte një agjendë dinamike të prioritetëve. Sidoqoftë, dinamika e madhe e zgjedhjeve do t'i mbajë partitë në pushtet të zëna me fushatën duke i shkëputur zyrtarët nga detyrat e tyre, dhe duke i dhënë hapësirë opozitës të ashpërsojë qëndrimet e tyre kundrejt qeverisë dhe politikave të saj.

Kabineti qeveritar i Ramush Haradinajt trashëgoi një agjendë të ngjeshur dhe shumë sfiduese. Gjendja dhe konteksti politik nuk janë shumë favorizuese. Detyrat dhe obligimet e listuara më poshtë paraqesin prioritetet që kanë rëndësi për qytetarët, institucionet, partnerët ndërkombëtarë dhe për agjendën evropiane të Kosovës”.

Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi - Kryeministri Haradinaj mori një vendim të madh që në ditën e tij të parë në detyrë. Qeveria shkarkoi

Komisionin shtetëror për shenjimin dhe mirëmbajtjen e kufijve, të cilin e kishte kundërshtuar për vite me radhë. Komisioni i sapo emëruar, kryesisht i përbërë nga ata që kundërshtuan marrëveshjen e mëhershme, ka të njëjtin qëndrim me Haradinajn; është pothuajse e sigurtë se ai nuk do të miratojë marrëveshjen aktuale dhe do të kërkojë rinegociim. Kosova dhe Mali i Zi nënshkruan marrëveshjen për kufirin në gusht 2015; Para anëtarësimit në NATO, Mali i Zi ratifikoi marrëveshjen në dhjetor 2015. AAK e Haradinajt së bashku me Vetëvendosjen dhe NISMA refuzuan marrëveshjen që nga fillimi.

Vendimi i qeverisë për komisionin e ri mund të ketë kënaqur shumë qytetarë të Kosovës, por ka zhgënjyer shumë [evropianët dhe SHBA-të](#). Kosova nuk arriti të marr përkrashjen e qeverisë së Malit të Zi për shqyrtimin e marrëveshjes. Gjatë vizitës në Podgoricë, Ministri i Jashtëm Pacolli pranoi se "ratifikimi i demarkacionit të kufirit me Malin e Zi është i pamundur të bëhet për momentin" përkundër thirrjeve të ndërkombëtarëve për ta bërë këtë. Qeveria e Malit të Zi nuk shfaq vullnet për të rishikuar marrëveshjen; U tha se, për Podgoricën, kjo çështje është e mbyllur.

Çështja është bërë e komplikuar dhe pothuajse e pazgjidhshme; nuk pritet të zgjidhet shpejt. Vendimet e qeverisë kënaqën një pjesë të opozitës (Vetëvendosjen), por jo edhe pjesën tjetër (LDK-në). Sidoqoftë, më e rëndësishme është se si vendimi i Kryeministrit do të reflektojë në marrëdhëniet e partive në pushtet, veçanërisht me PDK-në e cila mbështetë marrëveshjen e tanishme kufitare, të nënshkruar nga ish lideri i PDK-së dhe Presidenti i tanishëm, Hashim Thaçi. PDK mbështetë ratifikimin e marrëveshjes aktuale; për ata, mbështetja publike varet nga sigurimi i liberalizimit të vizave me BE-në, për qytetarët e Kosovës, të cilën gjë liderët e tyre e kanë premtuar gjatë.

Demarkacioni me Malin e Zi mbetet një nga dy kriteret e BE-së për t'i dhënë Kosovës liberalizimin e vizave. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një tjetër kriter, ku megjithatë është shënuar progres deri diku. Qeveria e re nuk duhet të përsërisë gabimet e paraardhësve. Çdo zgjidhje e qëndrueshme për demarkacionin me Malin e Zi kërkon një proces gjithëpërfshirës; Haradinaj duhet të përfshijë të gjitha subjektet politike, një grup më të madh të ekspertëve dhe shoqërinë civile, në kërkim të rezultateve të shpejta për këtë çështje të ndërlikuar. Qeveria e tij vështirë se do të qëndrojë gjatë nëse nuk siguron liberalizimin e vizave.

ERA dhe MSA – Në nëntor 2016, Qeveria e Kosovës miratoi një plan të reformave me prioritet në kuadër të të ashtuquajturës Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) që duhej zbatuar kryesisht përgjatë vitit 2017. [ARE](#) është pjesë e dialogut të nivelit të lartë Kosovë-BE dhe planet e veprimit kanë marrë mbështetjen e Kuvendit. ARE parasheh përmirësim në tri fusha: Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve, Punësimi dhe Arsimi. Deri më tani, progresi është i vogël dhe mbetet shumë për t'u zbatuar. E penguar nga kriza e vazhdueshme politike dhe nga zgjedhjet e parakohshme, qeveria e kaluar dështoi t'i implementojë reformat; shpesh nuk kishte vullnet për të vepruar.

Zbatimi i të dyjave, [MSA-së](#) dhe ARE-s, kërkon koordinim të lartë të qeverisë e poashtu edhe vullnet politik. Nëse merret seriozisht, ARE ka potencial për të ndryshuar dinamikën e bërjes së politikave në institucione. Kryeministri tregoi shenja përkushtimi ndaj agjendës së BE-së; në ditët e tij të para, ai mbledhi Grupin punues ndërministror për ARE dhe Këshillin ministror për integritet evropian. Ai u zotua të mbajë takime koordinuese javore dhe të zbatojë prioritetet e ARE.

Më 29 shtator, qeveria zbatoi një kërkesë thelbësore të ARE; ajo shkarkoi disa nga anëtarët e bordit dhe drejtorët e agjencive të pavarura dhe të kompanive publike, të emëruar nga qeveritë e mëparshme. Agjencia Kundër Korrupsionit pati gjetur se emrat [ishin aktivistë politikë dhe të emëruar në kundërshtim me ligjin](#). Qeveria e Isa Mustafës kishte refuzuar zbatimin e këtij opinionioni.

Ndryshimet në kuadrin ligjor janë urgjente. Financat e partive politike mbeten në thelb jo-transparente; ende mbetet punë e papërfunduar lidhur me ligjin për pezullimin e zyrtarëve publikë të akuzuar për korrupsion, të involvuar në konflikt interesi të zyrtarëve publikë dhe anëtarëve të agjencive të pavarura. ARE nuk duhet të lihet anash dhe në tërësi duhet të ndiqet dhe të përfshihet në agjendën e qeverisë së re; ajo duhet të përfshijë një kornizë të re kohore që të zbatohet përgjatë vitit 2018. Ajo ka vlerë vetëm si një pako e tërë dhe qeveria e re duhet seriozisht të ndjekë zbatimin, derisa kuvendi duhet të monitorojë progresin. Qeveria ka zbatuar më pak se gjysmën e masave afatshkurtra të MSA-së të planifikuara për vitin e parë. Masat kryesore nuk janë zbatuar, si ligjet ashtu dhe aktet nën-ligjore. Qeveria dhe BE po negociojnë mbështetjen buxhetore për treguesit e zbatuar. Kosova rrezikon humbjen e mjeteve financiare nëse dështon të përshpejtojë zbatimin

Asociacioni i komunave me shumicë serbe – Bashkë me marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, marrëveshja për asociacionin e komunave me shumicë serbe (AKS), e nënshkruar në gusht 2015, shkaktoi një [krizë të pashembullt](#) duke kërcënuar qëndrueshmërinë e institucioneve të vendit. Marrëveshja provokoi reagime të opozitës, gjë që çoi në përdorimin e gazit lotsjellës në Kuvend. Gjykata Kushtetuese gjeti se [marrëveshja nuk ishte tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës](#). Qeveria e udhëhequr nga LDK nuk ishte e gatshme ta zbatonte; atë e frikësuan reagimet e opozitës dhe të publikut. Marrëveshja për asociacionin arriti kulmin e kontradiktave në vend në lidhje me dialogun me Serbinë. Marrëdhëniet e brishta midis qeverisë dhe opozitës e bënë të pamundur zbatimin e saj.

Megjithatë, me pak më shumë guxim, qeveria e Haradinajt mund ta zbatojë marrëveshjen për asociacionin. Përfaqësuesit serbë kanë më shumë besim tek ai dhe tek partneri i tij Kadri Veseli. Opozita do ta ketë të vështirë të kundërshtojë zbatimin e këtij trupi të ri, nëse respektohet vendimi i gjykatës. Për të bërë këtë proces më të patrazuar, qeveria duhet të lansojë një udhërrëfyes për zbatimin e plotë të saj; ai duhet të përfshijë konsultime, përfshirjen e të gjithë akterëve, përcaktimin e afateve të qarta kohore dhe të parimeve për formimin e këtij institucioni hibrid.

Sa më herët që Kosova e zbaton asociacionin, aq më mirë; lënja e pazbatuar e marrëveshjes për asociacionin, do të bëjë që kjo temë të futet në pakon gjithëpërfshirëse të fazës së dytë të dialogut me Serbinë, ku mund të fitojë edhe më shumë kompetenca, duke e bërë atë më komplekse dhe më të vështirë për t'u pranuar. Zbatimi i kësaj dhe i marrëveshjeve tjera do të ndikonin për të mirë në imazhin e Kosovës; duke dëshmuar se asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk e ndan Kosovën, por përkundrazi forcon lidhjet e qytetarëve serbë me qeverinë e Prishtinës si dhe rritë besimin e publikut në procesin e dialogut. Kosova duhet të punojë intensivisht në zbatimin e marrëveshjeve tjera, të ndërlidhura me gjyqësorin, telekomin, lirinë e lëvizjes, si dhe të insistojë në zbatimin e marrëveshjes për energjinë dhe largimin e institucioneve paralele të financuara nga Serbia, të dyja këto janë në duart e Beogradit.

Dialogu me Serbinë – Si kudo tjetër, vërehet një fokus i shtuar i politikave në lidhje me çështjet e brendshme. Adresimi i politikave të shtet-ndërtimit, korrupsionit, sundimit të ligjit, papunësisë, janë politika që ndihmojnë palët të rrisin përkrahjen e publikut. Liderët e Kosovës janë më pak të prirur në këtë

kohë, të flasin për dialogun me Serbinë; kjo temë është bërë shumë jopopullore dhe qytetarët nuk e pëlqejnë. Qeveria e mëparshme ngurroi t'i zbatojë marrëveshjet, e negociuara ekskluzivisht nga Presidenti Hashim Thaçi, atëherë në cilësinë e Kryeministrit.

Këtë verë, presidentët e Kosovës dhe Serbisë filluan përgatitjet për një tjetër fazë, të gjatë dhe komplekse të normalizimit. Dinamikat e brendshme në Kosovë nuk janë edhe aq të favorshme. Të panjohurat e asaj që përmban pakoja e ardhshme e normalizimit po frustron edhe më shumë si politikanët vendorë ashtu edhe publikun.

Me mbështetjen e Shefes së EEAS Federica Mogherini, presidentët e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vučić do të udhëheqin dialogun. Në Serbi, kjo është më e zbatueshme. Në Kosovë, Presidenti Thaçi do të ketë nevojë për një mbështetje më të gjerë; ai synon të ndërtojë një ekip të unitetit që përfaqëson institucionet dhe subjektet kryesore politike. Kryeministri Haradinaj mbështetë udhëheqjen e dialogut nga Presidenti Thaçi, por kjo nuk do të jetë e mjaftueshme. Partitë opozitare ende refuzojnë bashkëpunimin me Presidentin Thaçi; ata dhe segmente të tjera të qeverisë kërkojnë një rol të shtuar të ekzekutivit në çështjen e dialogut me Serbinë; një zyrtar qeveritar tha se një figurë e lartë politike duhet të udhëheqë zyrën e qeverisë për dialogun me Serbinë. Nën udhëheqjen e Haradinajt, Ministria e Dialogut përgjegjëse për zbatimin dhe koordinimin e dialogut u shua.

Kosova nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të përgatitet për një dialog intensiv dhe disa vjeçarë me Serbinë; së shpejti, liderët e qeverisë dhe të opozitës duhet të marrin vendime të rëndësishme. Shoqëria civile është e gatshme të angazhohet në mbështetje të dialogut.

Sundimi i ligjit – Sundimi i ligjit mbetet i dobët dhe joefikas. Haradinaj pranoi se [korrupsioni është 'endemik në të gjitha nivelet institucionale dhe shoqërore'](#). Magjithatë, kabineti i tij përfshinë zyrtarë të lartë me raste gjyqësore kundër tyre. Korrupsioni, ndikimi në punësim, mungesa e efikasitetit, numri i ulët i gjyqtarëve dhe prokurorëve, kapacitetet e lemtuara, organet udhëheqëse jo-funksionale të Sundimit të Ligjit rezultojnë në besimin më të ulët në gjyqësi, në mesin e institucioneve publike; [77,5 përqind e kosovarëve i perceptojnë gjykatat si të ndikuara nga politika dhe të korruptuara](#). Presioni për reforma gjithëpërfshirëse në sektorin e rendit dhe ligjit është në rritje. Për të përmirësuar performancën dhe perceptimin e

publikut për gjyqësorin, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë disa hapa, kryesisht të sigurojë mos-ndërhyrjet politike, si dhe të shtojë buxhetin.

Rishikimi i ardhshëm funksional i institucioneve të sundimit të ligjit duhet të përfshijë masa që sigurojnë më shumë llogaridhënie, transparencë, qasje në drejtësi, dhe që eliminojnë jofunksionimin e gjyqësorit. Vetëm plotësim-ndryshimi i Kodit Penal nuk do të mjaftojë. Duhet të merren parasyshtë ndryshime rrënjësore në administrimin e gjyqësorit. Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është thelbësore. Qeveria e re duhet të rrisë buxhetin për këshillin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës; verifikimi/vetting-u dhe trajnimi i stafit administrativ është jetik. Prezantimi i pakos për pensionim të parakohshëm për gjyqtarët dhe stafin administrativ do të hapte rrugën që profesionistë të rinjë, të trajnuar dhe kompetentë, t'i bashkëngjiten gjyqësorit. Strukturat e reja të organeve mbikëqyrëse duhet të përshijnë njësi të nivelit të lartë të inspektimit.

Reformimi i Administratës Publike – Kosova ka të gjitha insitucionet funksionale; në shumë fusha ato janë më shumë në numër se sa që është e nevojshme por megjithatë funksionimi i tyre mbetet i dobët; një administratë e fragmentuar dhe e ndikuar politikisht në shumicën e rasteve dështon të performojë. Ajo është e politizuar skajshëm, me kapacitete të dobëta, veçanërisht në nivelin e lartë menaxhues. Ligji për shërbimin civil, organizimin e administratës publike si dhe ligji për pagat e nëpunësve civilë që rregullojnë funksionimin e administratës publike, si pjesë e pakos së Agjendës për Reforma Evropiane, kanë qenë për vite të tëra në proces. Qeveritë e njëpasnjëshme kanë ngurruar të zbatojnë këto ligje. Reformat synojnë të adresojnë dobësitë në menxhim, planifikim të politikave, koordinim, monitorim, raportim si dhe çështjet e ndërlidhura me skemën aktuale të pagave dhe përfitimeve.

Me prioritet, qeveria e re duhet të përmbyllë pakon legislative. Reformat në administratën publike janë gjithashtu të nevojshme për të siguruar mbështetje të drejtëpërdetë buxhetore; BE ka premtuar 25 milion euro në tetë faza të ndryshme. Një zyrtar i lartë i qeverisë paralajmëroi se zbatimi i plotë i këtyre reformave do të jetë i mundshëm vetëm nëse qeveria siguron mbështetje të gjerë politike.

Arsimi – Arsimi në Kosovë është i zhytur në korrupsion dhe ndërhyrje politike, duke ngërthyer biznesin, paranë dhe interesin. Performanca e dobët e [Kosovës në testin e PISA-s](#) duhet të shërbejë si thirrje për zgjim. Arsimi

është temë për të cilën, në të kaluarën, ndërkombëtarët kanë treguar shumë pak interesim. Ngjashëm si me administratën publike, arsimit është lënë shumë pas dore, derisa qeveritë e njëpasnjëshme e kanë përdorur këtë punëdhënës të madh publik si burim dhe mundësi për të fituar mbështetje politike. Në pranverën e vitit 2017, interesat e politikanëve dhe pronarët e sektorit të arsimit privat, bllokuan miratimin e ligjit të ri për arsimin e lartë.

Trendet duhet të ndryshojnë dhe qeveria e re duhet të angazhohet për të reformuar të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Nëse provohet kjo, donatorët janë të gatshëm të investojnë në këto reforma; Gjithatu, BE është e vullnetshme të mobilizojë edhe institucione tjera financiare. Shumë pak dihet në publik lidhur me emrin e ministrit të ri të arsimit. Për shumë kë, të qenurit ministër i arsimit dhe në të njëjtën kohë të garosh në zgjedhjet lokale për kryetar të Prishtinës nuk ofron një fillim premtues. Sidoqoftë, një plan i mirë, mbështetur fuqishëm nga qeveria dhe vullneti politik, mund t'i vë reformat në rrugën e duhur.

Shëndetësia – Shëndetësia është një tjetër sektor i shërbimit publik rëndë i korruptuar. Kjo përfshinë shumë shtresa të institucioneve, sektorëve, mjekëve dhe interesave private. Qeveria e Isa Mustafës dështoi të krijojë skemën e sigurimeve shëndetësore dhe të reformojë shërbimet shëndetësore. Ligji për sigurimet e detyrueshme shëndetësore duhet të kalojë derisa shërbimet e kujdesit shëndetësor primar duhet t'ju përgjigjen nevojave publike. Para se të bëhen këto reforma, qeveria e re duhet të marrë hapa të cilët rrënjësisht përmirësojnë menaxhimin e qendrave shëndetësore, derisa hetime të rasteve dhe shkarkimet e të inkrimnuarve dhe menaxherëve janë të nevojshme. Kryeministri Haradinaj deklaroi se fokusi i qeverisë së re do të jetë në shëndetësi; simbolikisht, në ditën e parë të punës, ai vizitoi Qendrën Klinike Universitare.

Ministri i ri i shëndetësisë, një figurë politike me ndikim, ka rastin dhe duhet të marrë masa të fuqishme për të ndryshuar strukturat e menaxhimit dhe të përmbyllë reformat. Shqetësuese është vdekja e [katër pacientëve](#) në rrethana të dyshimta, në salla të operimeve, dy ditë para se Haradinaj të marrë detyrën. Ky zhvillim edhe njëherë tregon nevojën për vëmendje të shtuar dhe për reforma. Incidenti është një dëshmi shtesë për dështimin sistematik të shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimit, derisa rasti ngërthen korrupsionin, përfshirë organin shqyrtues të prokurimit dhe dështimin e institucioneve përgjegjëse. Ministri i ri dhe qeveria duhet t'ë kërkojnë llogari

nga personat përgjegjës. Ndryshimet duhet të përfshijnë reformimin e strukturës së menaxhmentit.

Transformimi i FKS-së në ushtri – Liderët kosovarë insistojnë në transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në ushtri. Debati për këtë çështje ka ngjallur emocione derisa nga të gjithë konsiderohet si komponentë e rëndësishme e sovranitetit dhe shtet-ndërtimit. Propozimi gjithëpërfshirës i Ahtisaarit për statusin final i dha Kosovës të drejtën të ketë një ushtri të vogël të përbërë prej 5000 trupave aktivë dhe 2500 rezervë. Transformimi ishte vendosur të ndodhte pesë vjet pas shpalljes së pavarësisë, kur FSK-ja të arrijë aftësitë e duhura operationale. Aktualisht, sipas dispozitave kalimtare kushtetuese, Forca e Sigurisë së Kosovës ka mandat të kufizuar. Transformimi kërkon ndryshime kushtetuese, të cilat mund të bëhen vetëm me miratimin e 2/3 të të gjitha pakicave në kuvend. Përfaqësuesit serbë, të udhëzuar nga Beogradi, kundërshtojnë idenë që Kosova të ketë ushtri dhe refuzojnë ndryshimet kushtetuese. Në fillim të pranverës, Presidenti Thaçi u [përpoq të ndryshonte mandatin e FSK-së përmes ligjit](#). Partnerët ndërkombëtarë, SHBA, BE dhe NATO [reaguan ashpër](#).

Brenda këtij viti, qeveria e re planifikon të nxjerrë ligjin për transformimin e forcave të sigurisë; të paktën kjo është çfarë parashihet në pakon legjislative. Nëse bëhet kjo, qeveria do të përballlet me kundërshtim të ngjashëm nga bashkësia ndërkombëtare. Miqtë e Kosovës dhe aleatët kryesorë të NATO-s mbështesin plotësisht të drejtën e Kosovës për të pasur ushtri, por kërkojnë një udhërrëfyes të qëndrueshëm, konciz dhe gjithëpërfshirës për krijimin e rregullt dhe të drejtë të forcave të armatosura. Kjo nënkupton se qeveria dhe partitë politike duhet të jenë të durueshme dhe konsistente; kjo rrugë poashtu, kërkon konsensus jo vetëm lidhur me atë se çfarë ushtrie dëshiron Kosova të ketë, por edhe lidhur me procesin e transformimit, e që mund të zgjasë me vite. Procesi është kompleks dhe kërkon ecje të kujdesshme së bashku me pakicat. Bashkëpunimi, lobimi dhe avokimi për mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë është njësoj i rëndësishëm.

Bashkëpunimi me FMN-në – Aktualisht, Kosova nuk ka në fuqi asnjë marrëveshje ‘Stand By’ me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Marrëveshja e fundit ka përfunduar në fillimin e gushtit të këtij viti. Qeveria e Kosovës përfitoi 170 nga 185 milion Euro të zotuar nga FMN për programin 2015-2017. Programi u fokusua në [qëndrueshmërinë fiskale, reformat në legjislacion dhe shpenzimet, në veçanti në skemën pensionale të veteranëve](#)

të luftës. Ish-ministrat, Avdullah Hoti i financave dhe Arban Abrashi i mirëqenies sociale, kanë zbatuar një pjesë të konsiderueshme të programit dhe kanë bërë progres drejt zgjidhjes së skemës pensionale për veteranët e luftës. Qeveria dhe FMN kanë vendosur një kufi të shpenzimeve për veteranët në 0,7 përqind të Bruto Produktit të Brendshëm prej 6,2 miliardë euro; në shifra reale qeveria lejohet të shpenzojë rreth 43 milion euro për këtë skemë. Sidoqoftë, ambiciet politike dhe zgjedhjet e parakohshme penguan të dyja: stabilitetin financiar dhe reformën e skemave pensionale për veteranët. Qeveria LDK-PDK e Isa Mustafës kishte paraqitur një buxhet të fryer për vitin 2017 dhe vazhdoi të paguante pensionet e pakategorizuara për veteranët. Me rishikimin e buxhetit në mes të vitit, qeveria e re vazhdoi të paguante veteranët në kundërshtim me marrëveshjen e përkohshme për shpenzimet buxhetore për këtë skemë sociale, e cila ishte vendosur të jetë 38 milion euro për vitin 2017; megjithatë, pensionet për veteranët ishin më të ulëta për muajin gusht.


Qeveria e Haradinajt urgjentisht duhet të korrigojë skemën pensionale në bazë të zotimeve të qeverisë paraprake. Ministri i ri i financave paralajmëroi zvogëlimin e projeksioneve buxhetore për vitin 2017, në drejtim të shifrave më reale. Rritja buxhetore varet shumë nga aftësia për të luftuar ekonominë joformale, e cila thuhet se, përbënë më shumë se 30 përqind të bruto produktit të brendshëm. Evazioni fiskal në pikat kufitare e edhe më shumë brenda kufijve është burimi kryesor i ekonomisë joformale. Kryeministri Haradinaj duhet të vihet në presion për të bërë përparime në këtë çështje. Asnjë nga politikat e tij për shëndetësinë, arsimin etj., nuk do të japin fryte me burimet aktuale buxhetore. Qeveria duhet menjëherë të kërkojë një program të ri me FMN-në; çdo marrëveshje e re duhet të priorizojë luftën kundër ekonomisë joformale. Reformimi i skemave sociale është gjithashtu i rëndësishëm.

Politika e Jashtme – Kosova po humbet terren në politikën e jashtme. Qeveritë po ndjekin çështjet e integritimit në BE; zbatimin e MSA-së dhe ARE, por pak është bërë në politikën e jashtme apo për çështjet rajonale. Kryeministri Haradinaj nuk ka paraqitur ndonjë plan apo politikë konkrete. Ministri i Jashtëm Pacolli i ka dhënë prioritet lobimit për më shumë njohje. Këtë vjeshtë, Kosova tërhoqi kërkesën për anëtarësim në INTERPOL dhe në UNESCO, kundrejt një lobimi agresiv dhe të vazhdueshëm të Serbisë. Ishte vendim i mençur, por për shumëkë vendimi reflekton dështimin e qeverive të dëritanishme për të konsoliduar një agjendë të qëndrueshme të politikës së

jashtme. Politika e jashtme e Kosovës duhet të kursehet nga paqëndrueshmëria e pafundme e tensioneve të brendshme politike e që vazhdojnë të shmangin vëmendjen nga çështjet shumë të rëndësishme të njohjeve diplomatike dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare për Kosovën. Ashtu sikurse me integrimin në BE, politika e jashtme, bashkëpunimi rajonal dhe dialogu me Serbinë duhet të jenë tema të politikave nacionale që përfshijnë bashkëpunim të rregullt mes qeverisë dhe opozitës.

Çështja tjetër urgjente ndërlidhet me investimet në sektorin e energjisë. Qeveria e re, gjithashtu, duhet të rrisë interesimin për agjendën e Procesit të Berlinit; ajo duhet të bëjë vlerësimin e programeve dhe projekteve. Një zyrtar i lartë i kabinetit të ri qeveritar duhet të emërohet për të koordinuar dhe përgatitur qeverinë për agjendën e takimit të ardhshëm të samitit të Londrës.

Shënim: Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan punon në shumë prej prioriteteve të listuara në këtë artikull. Ne, monitorojmë dhe bëjmë hulumtime të detajuara për temat thelbësore dhe politikat në Kosovë. Një numër i raporteve për tema të caktuara (duke përfshirë rekomandime të zbatueshme) do të publikohen në muajt në vijim.



Ky publikim është financuar nga:

Projekti për Promovimin e Shoqërisë Demokratike (DSP) - Financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovë për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Grupit për hulumtimin e politikave në Ballkan dhe nuk përfaqëson pozicionin e SCO-K, DANIDA ose KCSF.

dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë

Mohim i përgjegjës: Qëndrimet dhe analizat në këtë artikull janë tërësisht të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG)